



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 74, DATË 03.09.2020

MBI  
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “STAR” SH.P.K., PËR  
RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIN RADIOFONIK PRIVAT VENDOR  
“RADIO STAR”

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Samir	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Shoqëria “Star” sh.p.k.

Objekt: Mosrinovimi i licencës së shoqërisë “Star” sh.p.k., për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Star”

Baza Bigjore: Neni 19, pika 16 dhe neni 68, germa “a” i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, rregullorja “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, të ndryshuar,

VËREN

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (sot Autoriteti i Mediave Audiovizive) me vendimin nr. 334, datë 18.04.2005, ka kaluar të drejtat e licencës së shoqërisë “F.K.T” sh.p.k., te shoqëria “Star” sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik privat vendor për të mbuluar me sinjal prefekturën Fier. Pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë së licencës, KKRT, me vendimin nr. 736, datë 29.09.2008, vendosi rinovimin e licencës së këtij subjekti dhe AMA me vendimin nr. 85, datë 16.05.2018 ka rinovuar afatin e vlefshmërisë së licencës së këtij subjekti. Afati i vlefshmërisë së licencës ka përfunduar në datën 02.05.2019.

Në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregullores “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, si dhe në zbatim të urdhrin nr. 190, datë 08.07.2019 të Kryetarit të AMA-s, u mbledh Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit, për të shqyrtuar aplikimin nr. 1862/1 prot., datë 02.05.2019 të shoqërisë “Star” sh.p.k., për rinovimin e licencës së subjektit audio privat vendor “Radio Star”.

Aplikimi i subjektit ka rezultuar me mangësi në dokumentacion, pasi nuk ishin paraqitur:

- Vërtetimi i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (dëshmia e penaltetit) si dhe deklarata noteriale mbi aksionet/kuotat në subjekte të tjerë audio/audiovizivë të z. Astrit Hoxha, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë “Star” sh.p.k.;
- Garancia bankare në masën 100,000 lekë, e ngurtësuar për një periudhë 6-mujore;
- Kontratë/marrëveshje për respektimin e të drejtave të transmetimit dhe atyre të autorit (origjinale/kopje e noterizuar);
- Karakteristikat teknike të pikës së transmetimit, si koordinatat gjeografike, fuqia nominale e transmetimit, fuqia efektive izotropike e rrezatuar (EIRP), diagramat e antenës, azimuth-i, etj;
- Të dhënat mbi numrin e punonjësve që subjekti parashikon të punësojë si dhe mënyra e organizimit dhe drejtimit të shoqërisë (organigrama).

Duke qenë se aplikimi rezultoi me mangësi, AMA, me shkresat nr. 1862/2 prot., datë 30.07.2019, nr. 3831 prot., datë 25.10.2019, nr. 54 prot., datë 08.01.2020, nr. 1925 prot., datë 09.07.2020 dhe nr. 1925/1 prot., datë 13.08.2020, ka kërkuar në mënyrë të përsëritur plotësimin e dokumentacionit.

Po ashtu, AMA vëren se në cilësinë e organit kolegjal e ka marrë në shqyrtim çështjen e rinovimit të licencës së këtij subjekti duke i dhënë mundësi për depozitimin e dokumentacionit plotësues, ndërkohë që nga subjekti nuk ka patur reagim.

Në shkresën e fundit, të dërguar në muajin gusht, subjektit i është bërë me dije se nëse nuk do të depozitohet dokumentacioni i kërkuar brenda datës 31 gusht 2020, AMA do të vendosë rrëzimin e aplikimit për rinovimin e licencës së subjektit audio privat “Radio Star” dhe mosrinovimin e licencës së subjektit.

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti ka detyrime financiare ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit për vitin 2020, në masën 67,792 lekë. Prej të cilave 592 lekë për kamatëvonesa të vitit 2019; 60,000 lekë për pagesë vjetore për licencë dhe 9,600 lekë për tarifë për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive, të njoftuara nga AMA me shkresën nr. 339 prot., datë 28.01.2020.

Gjithashtu subjekti është rikujtuar për shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit për vitin 2020 me shkresat me nr. 1463 prot., datë 10.06.2020 dhe nr. 1586 prot., datë 19.06.2020.

AMA konstaton se subjekti, pavarësisht njoftimeve dhe kërkesave të përsëritura për të sjellë aplikimin në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, nuk ka depozituar dokumentacion shtesë.

Neni 68 i ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar parashikon se: "*Licenca... bëhet e pavlefshme kur... mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar*".

Për sa më sipër, AMA arrin në përfundimin që aplikimi i shoqërisë "Star" sh.p.k., për rinovimin e licencës së subjektit audio "Radio Star", duhet të rrëzohet,

### PËR KËTO ARSYE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16 dhe nenit 68, germa "a" të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar,

### VENDOSI:

1. Mosrinovimin e licencës së shoqërisë "Star" sh.p.k., për subjektin radiofonik privat vendor "Radio Star".
2. Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë "Star" sh.p.k., për subjektin radiofonik privat vendor "Radio Star".
3. Shoqëria "Radio Star" sh.p.k., me njoftimin e këtij vendimi, ka detyrimin ligjor të ndërpresë menjëherë transmetimin.
4. Ngarkohet administrata e AMA-s për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar:**

**Gentian SALA**

**Zëvendëskryetar:**

**Sami NEZAJ**

**Anëtarë:**

**Agron GJEKMARKAJ**

**Gledis GJIPALI**

**Suela MUSTA**